VENDIM
Nr.918, datë 2.7.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LAÇ TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Laç të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Laç të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.162, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Laç, të qarkut të Lezhës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Laç për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Laç Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
118	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
1-27	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
42,55,56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
28-35	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
533-535	Varrezat publike	Në pronësi
142-177,190,191,198,199, 203-330,375-532,564-575,577,578,586,588-591,599	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

178-189,192-197,200-202,331-374,549,576,883-928,930-979,981-1043,1045-1108,1110-1167,1169-1222,1224-1238,1240-1246,1248-1278,1340-1430	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
536	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
537,538,543,544,560-563,579-585,587,592-598,614-616,621,724-729,731-738,740-743,746-807	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
65-98	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
1436-1439	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1440,1441,1523,1527	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
1501-1507	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e kanalizimeve	Në pronësi